


# Histori Suksesi

## Rehabilitimi dhe integrimi i viktimave të trafikimit nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

**M.V., e mbijetuar e trafikimit, përfituese e organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë” u përball me humbjen e punës si pasojë e pandemisë Covid-19. E gjendur përballë kësaj situatë, tashmë e profilizuar si rrobaqepëse pas një kursi profesional dhe eksperiencës në një atelie ajo kishte dëshirën që të hapte një rrobaqepsi, pranë vendit ku jetonte. Këtë ide ia propozoi organizatës, e cila e mbështeti atë.**



**Rrobaqepësia është një ambjent i vogël ku po realizohen shumë procese të qepjes.**

– “Duke menduar për shumëllojshmërinë dhe konkurrencën e bizneseve të tilla mendova të fusja si risi qëndistarinë. Kështu që dyqani u kompletua me të gjitha pajisjet profesionale për realizimin e funksionit të tij. Në fillim punova shumë me riparime në mënyrë të tillë që të mund të fitoja klientelë. Pasi klientët fituan besimin, u rriten kërkesat për shërbime të tjera dhe duke qenë së maskat u bënë të domosdoshme, fillova të krijoj modele të ndryshme duke rritur dukshëm edhe volumin e punës”

– shprehet M.

**D&E ka mbështetur M.V në të gjithë procesin e hapjes së biznesit. Fillimisht është punuar në përgatitjen e planit të biznesit; blerjen e të gjitha pajisjeve të nevojshme të dyqanit të rrobaqepsisë. Gjithashtu M.V. është mbështetur për tre muajt e parë të aktivitetit me pagesën e qerasë, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, marrjen e licencës, pagesën e taksave etj.**

**“Ndihem shumë e lumtur që kam patur mundësinë të kem mbështetje në një situatë kaq të vështirë. Pas kësaj ndihme kam aftësinë t’ja dal vetë, t’a vetëmenaxhoj këtë biznes dhe e shikoj veten më të përgatitur për më tej”**